

RISITË PËR PLOTËSIMIN E NEVOJAVE DHE TENDENCAVE BASHKËKOHORE NË FIZIKË DHE MËSIMDHËNIE

***ALION ALIZOTI, POLIKRON DHOQINA**

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Fizikës

e-mail: alion.alizoti@fshn.edu.al

Përmbledhje

Prej vitesh, Shqipëria bashkë me vende të tjera evropiane dhe botërore kanë aplikuar sistemin edukativ me nëntë vjet të edukimit primar dhe tre vjet të edukimit sekondar. Bashkimi Europian synon struktura dhe standarte cilësore, ndërkohë që UNESCO synon edukimin e drejtë dhe cilësor. Rekomandime ndërkombëtare dhe kombëtare e kanë vënë theksin kryesisht në zhvillimin e kurrikulave të reja në shkencat e natyrës, njësoj si në të gjithë sistemin arsimor. Zhvillimet aktuale në fizikë, shkenca natyrore dhe shkenca të tjera kanë diktuar pozita dhe implementime të reja në sasinë dhe cilësinë e dijes.

Fjalëkyçe: Edukim, fizikë, shkenca, projekte, risi.

Abstract

For years now, Albania along with other european and worldwide countries have applied the educational system with nine years of primary education and three years of secondary education. European Union aims quality structures and standarts, meanwhile UNESCO aims right and quality education. International and national recommendations have emphesazed mainly on the development of new curriculums in natural sciences, like in all educational system. Current developments in physics, natural sciences and other sciences have dictated new pozitions and implementations to the quantity and quality of knowledge.

Keywords: Education, physic, science, risi, projekte.

Hyrje

Me fillimin e mijëvjeçarit të ri, Shqipëria me vende të tjera evropiane dhe botërore, aplikuan një sistem të ri edukativ me nëntë vjet të edukimit primar plus tre vjet të edukimit sekondar. Iniciativën e hershme në këtë drejtim e ndërmorën në fillim të viteve 2000, Ministria e Arsimit dhe Shkencave, Instituti i Studimeve Pedagogjike dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës me Tryezat e

Rrumbullakëta. Gjatë viteve në vazhdim, edukimi 9 + 3 është konsoliduar në infrastrukturë, forma dhe përmbajtje. Natyrisht, që të dhëna statistikore në këtë drejtim do të ekspozonin një panoramë më të plotë të preferencave dhe pozicioneve të shkencave të natyrës në edukimin sekondar tre – vjeçar. Për këtë arsye, problemi i trajtimit të lëndës së fizikës në shkollën e mesme tre - vjeçare është parë me interes të veçantë. Qëllimi i studimit synon që duke u njohur me ngarkesat mësimore aktuale të mund të parashikohen strategji për të ardhmen. Meqënëse fizika bën pjesë në grupin e lëndëve të shkencave të natyrës, studimi përfshin edhe lëndë të tjera të këtij grupi. Mbi bazën e ngarkesës mësimore, përgatitjes së nxënësve dhe udhëzimeve institucionale, do të jetë më e lehtë të realizohen përshtatjet kurrikulare midis edukimit sekondar dhe edukimit terciar për shkencat e natyrës. Në këtë mënyrë, rikonstruksioni universitar i dijes tek nxënësit – studentë realizohet gradualisht dhe në vijueshmëri me njohuritë e marra që në shkollën e mesme.

Materiali dhe metodat

Aktualisht, në bazë të Zyrës Ndërkombëtare të Edukimit (UNESCO), Egjipti, Greqia, Franca, Anglia, Finlanda, Rusia, Brazili, Kina, Japonia, Shqipëria, kanë zhvilluar edukimin sekondar tre – vjeçar, ndërsa vende si Italia, Austria, Turqia, Spanja, SHBA, vazhdojnë me sistemet e mëparshme, 8 + 4 ose 10 + 2, (UNESCO, 2010/11).

Gjithashtu, nga këto të dhëna, ngarkesa e shkencave të natyrës me lëndët matematikë, fizikë, shkenca natyrale (biologji dhe kimi), paraqitet si në tabelë.


Meqënëse në vendin tonë lënda e fizikës paraqitet me ngarkesë të dobët në krahasim me lëndët dhe vendet e tjera, pedagogët e Fakultetit të Shkencave të Natyrës e kanë parë me shqetësim këtë situatë. Ata mendojnë që lënda e fizikës duhet të rritet si në cilësi ashtu edhe në sasi, dhe kjo mund të rregullohet në përfaqje me sisteme edukative të avancuara nga vende të ndryshme të botës (Alizoti, 2013).

Tabela 1. Ngarkesa në orë mësimore sipas lëndëve për çdo vend.

Vendi	Matematikë	Fizikë	Shkenca Natyrale
Shqipëria	10 orë	4 orë	10 orë
Greqia	8 – 11 orë	4 – 6 orë	3 – 5 orë
Finlanda	21 krs	8 krs	10 krs
Franca	7 – 10 orë	3 orë	3 orë
Rusia	6 orë	5 orë	3 orë

Japonia	18 orë	6 orë	18 orë
Brazili	10 orë	7 orë	13 orë
Italia	21 – 22 orë	13 orë	13 – 22 orë
Austria	7 – 10 orë	7 – 10 orë	10 – 15 orë
Turqia	5 orë	2 orë	2 orë
Spain	15 orë	3 orë	10 orë

Figura. 2: Shpërndarja në përqindje e orëve mësimore të lëndës së fizikës për çdo vend.



Sipas Indeksit Botëror të Edukimit, Indeksit të Zhvillimit Njerëzor, Forumit Ekonomik Botëror, UNDP, Finlanda paraqitet si vend me shumë përparësi në fushën e edukimit. Edukimi finlandez thekson që dija fizike duhet të përmirësohet në strukturë dhe epistemologji, dhe të pasurohet me elementë që kënaqin koherencën midis teorisë dhe eksperimenteve (Koponen, Mänty 2010).

Fillimisht, idetë janë pritur me pozitivitet nga stafet pedagogjike, për vendosjen e lidhjeve dinamike midis teorisë dhe eksperimenteve, si dhe në përmbushje me udhëzimet e Komunitetit European për zhvillimin e fizikës bashkëkohore.

Por, për Shqipërinë problemet primare kanë qenë dhe janë kryesisht ekonomike. Prandaj, sygjerimet nga institucionet arsimore kanë qenë dhe janë që nevojiten

financime direkte për furnizimin e shkollave të mesme me laboratore dhe bazë laboratorike. Bashkëpunimet e ngushta me personalitete të suksesëshme nga fushat e ekonomisë, mediave, dhe biznesit, u shoqëruan me inisiativa konkrete, siç ishte rasti i projekteve për kompetencat laboratorike (Ministria Arsimit – Fakulteti i Shkencave të Natyrës – Drejtoritë Arsimore – Banka Botërore).

Këto kontakte treguan që duhen ndërmarrë dhe realizuar disa veprime themelore:

1. Laboraret shkencore në shkolla duhet të stimulohen për të gjitha lëndët me bazë orientimet për masivizimin e dijes.
2. Përfshirja e çështjeve të kërkimit shkencor me shtrirje kudo në nivele të ndryshme arsimore dhe akademike.
3. Sensibilizimi mediatik politik dhe shoqëror i problemit të pajisjes së shkollave me ambiente dhe mjete laboratorike.
4. Zbatimi i skemave të reja strukturore dhe ekonomike për të rregulluar shpërndarjen e laboratorëve nga firma private në shkolla shtetërore, me projekte, sponsorizime dhe subvencionime nga shteti dhe subjekte private.

Rezultatet dhe diskutimet

Rritja cilësore e sasisë së dijes fizike me eksperimente, teori dhe aplikime është manifestuar në aktivitete të ndryshme, si punë praktike apo projekte me mjete shkollore dhe individuale. Financimi i shkollave për ambientet dhe aktivitetet laboratorike ndihmon gjerësisht formimin intelektual dhe fizik të anëtarëve të ardhshëm të Europës së Bashkuar.

Përmbushja e prioritetëve të Bashkimit European me procesin e Bolonjës dhe realizimi i synimeve të UNESCOs për një edukim të drejtë dhe cilësor, sollën një numër të konsiderueshëm risish strukturore, ligjore dhe ekonomike në vend (Alizoti, 2020). Disa nga këto risi që kanë ndihmuar zhvillimin e fizikës në drejtime multilaterale janë listuar si më poshtë:

1-Mbështetja financiare e drejtpërdrejtë e Tryezave të Rrumbullakëta (MASH – ISP – FSHN)

2-Financimi i projekteve të përbashkëta me tre palë pjesëmarrëse në projekt (MASH – BB – REKTORATI UT)

3-Financimi i mikroprojekteve që mundëson fitimin dhe mbajtjen e projekteve të mesme dhe vogla (MASH – REKTORATI UT - FSHN)

4-Financimi i projekteve nga Banka Botërore ose institucione të tjera, si një palë e tretë që nuk merr pjesë ose fitim të drejtpërdrejtë në projekt.

5-Investime në Sisteme Kompiuterike (Software & Technology) për të rritur saktësinë e matjeve.

6-Financimi dhe shtrirja e aktiviteteve me qëllim masivizimin dhe verifikimin e dijeve shkencore në të gjitha nivelet arsimore.

7-Zhvillimi i konferencave ndërkombëtare me financim të përbashkët nga organizatorët me aktivitete të vogla të projektuara brenda një aktiviteti të madh (Universitetet Shkodër, Tiranë, Korçë, etj)

8-Investimet e projekteve me drejtim informatizimin e proceseve mësimore (MASH, FSHN, DAR)

Literatura

UNESCO (2010/11): World Data on Education. 7th edition, 2010/11

<http://www.ibe.unesco.org/>

Alizoti A. (2013): Nevojat bashkëkohore në ekonominë e mësimdhënie së fizikës, Monitor, 2013

Alizoti A. (2020): Risitë ekonomike për plotësimin e nevojave bashkëkohore në fizikë dhe mësimdhënie, Monitor

Koponen T. I., Mäntylä T. (2010): Generative role of experiments in physics and in teaching physics: A suggestion for epistemological reconstruction, Department of Physical Sciences, University of Helsinki, Finland